

## **SEKSIONI 4**

### **OPERATORI EKONOMIK I AUTORIZUAR**

#### **Neni 40**

Aplikimi dhe autorizimi

1. Një operator ekonomik, i cili është i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe përmbush kriteret e vendosura në nenin 41, mund të aplikojë për statusin e operatorit ekonomik të autorizuar. Nëse vlerësohet e nevojshme, autoritetet doganore mund të konsultohen me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit sa i takon verifikimit të plotësisht të kriterëve të përcaktuara në nenin 41. Vendimi për dhënien e statusit të operatorit ekonomik të autorizuar është objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme.

2. Statusi i operatorit ekonomik të autorizuar ka të bëjë me llojet e autorizimeve të mëposhtme:

a) atë të një operatori ekonomik të autorizuar për “thjeshtësime doganore”, i cili i mundëson mbajtësit të tij përfitime për disa thjeshtësime, në përputhje me legjislacionin doganor; ose

b) atë të një operatori ekonomik të autorizuar për “sigurinë dhe mbrojtjen”, i cili i mundëson mbajtësit të tij lehtësi që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen.

3. Të dyja llojet e autorizimeve, të përcaktuara në pikën 2, mund të mbahen njëkohësisht.

4. Autoritetet doganore, në bazë të njohjes të statusit të operatorit ekonomik të autorizuar për thjeshtësi doganore dhe me kusht që të jenë plotësuar kërkesat që lidhen me një lloj specifik të thjeshtësimit, autorizojnë operatorin për të përfituar nga ky thjeshtësim. Autoritetet doganore nuk rishqyrtojnë ato kriteret, të cilat janë shqyrtuar një herë kur është dhënë statusi i operatorit ekonomik të autorizuar.

5. Operatori ekonomik i autorizuar, i përcaktuar në pikën 2, gëzon trajtim më të favorshëm se operatorët e tjerë ekonomikë përsa u përket kontrolleve doganore, në përputhje me llojin e autorizimit të dhënë, duke përfshirë më pak kontrolle fizike dhe dokumentare.

#### **Neni 41**

Dhënia e statusit

Aplikuesi, për t'iu dhënë statusi i operatorit ekonomik të autorizuar, duhet të plotësojë këto kritere:

- a) të mos ketë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura të legjislacionit doganor dhe tatimor;
- b) të mos jetë i proceduar penalisht për vepra penale që lidhen me aktivitetin ekonomik të aplikuesit;
- c) të demonstrojë një nivel të lartë kontrolli të veprimeve të tij dhe të lëvizjes së mallrave me anë të një sistemi që menaxhon regjistrimet tregtare dhe, kur është

Fletore Zyrtare nr.134, datë 22 gusht 2014

6096  
me vend, edhe regjistrimet e transportit, i cili lejon kryerjen e kontroleve të duhura doganore;

- ç) të ketë aftësi paguese që do të kërkohen për të provuar nëse aplikuesi ka gjendje të mirë financiare, e cila i lejon atij të përmbushë angazhimet që rrjedhin e lidhen me karakteristikat e llojit të aktivitetit në fjalë;
- d) për sa i takon autorizimit të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 40, të ketë standardet praktike të kompetencave ose kualifikimeve profesionale që lidhen direkt me aktivitetin e kryer;
- dh) për sa i takon autorizimit, të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 40, të ketë standardet e duhura të sigurisë dhe mbrojtjes, të cilat konsiderohen të plotësuara kur aplikuesi tregon se ai siguron masat e duhura për zbatimin e sigurisë dhe mbrojtjes së zinxhirit tregtar ndërkombëtar, përfshirë fushat e integritetit fizik dhe kontrollit të aksesit, proceset logjistike dhe trajtimet për lloje të veçanta mallrash, personel dhe identifikimin e partnerëve të tij të biznesit.

## **Neni 42**

Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

- a) thjeshtësitë e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 40;
- b) lehtësitë e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 40;
- c) trajtimet më të favorshme, të përcaktuara në pikën 5, të nenit 40;
- ç) modalitetet për aplikimin e kritereve, të përcaktuara në nenin 41.